



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 118/6 Prot

Tiranë, më 14.07.2022

**V E N D I M**

**Nr.96 , datë 14.07.2022**

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së disa veprimeve administrative, që kanë lidhje me ndalesa nga paga ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*\*, me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit Fier, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11; nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të nenit 90, të ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e ankesës së nëpunësit \*\*\*\*\*\*, për rikthimin e pagesave të ditëve të punës të ndalura, të konsideruara në shkelje të legjislacionit të shërbimit civil.

**VËREJ SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është protokolluar një kërkesë e nëpunësit \*\*\*\*\*\*, me nr. 118 prot., datë 28.01.2022, përmes së cilës ngrihet pretendimi se në disa raste të justifikuar të mungesave në punë, në periudha kohore të ndryshme, për shkaqe shëndetësore, pune apo familjare, për të cilat ka njoftuar eprorin direkt/titullarin e institucionit, e njëkohësisht ka dorëzuar dhe dokumentacion justifikues ligjor pranë zyrës së protokollit, padrejtësisht i është ndaluar paga.

Punonjësi në fjalë ka kërkuar sqarime për këto veprime administrative pranë administratës së institucionit, por nuk është bindur nga përgjigjet e dhëna, prandaj ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për konstatimin e shkeljeve ligjore të pretenduara si dhe rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, në zbatim të kompetencave të ngarkuara nga ligji.

Në kuadër të verifikimit të pretendimeve të mësipërme, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet shkresës me nr. 118/1 prot., datë 08.02.2022, ka kërkuar aktet e nxjerra nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër, për secilën ndalesë të ditëve të punës.

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme, nëpërmjet shkresës me nr. 418 prot., datë 14.02.2022, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër, ka dërguar dokumentacionin e kërkuar, duke parashtruar edhe argumentimin e tyre për çdo pretendim të ngritur nga ankuesi.

Konkretisht, mosmarrëveshja e lindur ka lidhje me aktet administrative të renditura më poshtë:

1. Urdhër i Brendshëm nr. 18, datë 27.05.2021 *“Për marrjen e masës urgjente të ndërprerjes së ditës së punës”* bazuar në listë prezencën e kryer po në këtë datë;
2. Urdhër i Brendshëm nr. 19, datë 01.06.2021 *“Për marrjen e masës urgjente të ndërprerjes së ditës së punës”*, mbi mungesat e pajustificuara për datat 1 Prill, 2 Prill dhe 23 Prill 2021;
3. Urdhër i Brendshëm nr. 22, datë 30.06.2021 *“Për marrjen e masës urgjente të ndërprerjes së ditës së punës”* për mungesë pa arsye në atë ditë;
4. Urdhër i Brendshëm nr. 23, datë 16.07.2021 *“Për marrjen e masës urgjente të ndërprerjes së ditës së punës”* për mungesë pa arsye në atë ditë;
5. Urdhër i Brendshëm nr. 38, datë 29.12.2021 *“Për marrjen e masës urgjente të ndërprerjes së ditës së punës”* dhënë për datën 15.12.2021, pasi punonjësi \*\*\*\*\* nuk është paraqitur në punë, bazuar në listë prezencën ditore të kryer në atë ditë;
6. Urdhër i Brendshëm nr. 36, datë 16.11.2021 *“Për marrjen e masës urgjente të ndërprerjes së ditës së punës”*, bazuar në
7. listë prezencën e kryer po në këtë datë.

Nga shqyrtimi i akteve të mësipërme dhe dokumentacionit që i shoqëron këto akte, si dhe referuar kronologjisë së nxjerrjes së akteve administrative mbi ndalesat e mbajtura të ditëve të punës në ngarkim të ankuesit, rezulton se ato përkojnë të gjitha me akt-konstatimet e mbajtura nga Njësia e Burimeve Njerëzore, me shënimin për mosprezencën e nëpunësit në punë.

Nga sqarimet e dhëna prej administratës së institucionit, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, dërguar me shkresën nr. 2245 prot, datë 15.06.2021, rezulton se ndalimet nga paga, si rregull janë kryer në listpagesën e muajit që është konstatuar mungesa, ndërsa arsyeja e ndalimit të pagës së nëpunësit \*\*\*\*\* , për disa ditë në listpagesën e muajit Qershor 2021 dhe jo të asaj të Prillit 2021, lidhet me faktin që ndërkohë është pritur që punonjësi të dorëzonte fizikisht raportin, apo dokumentin e ligjshëm justifikues të pretenduar, gjë nuk ka ndodhur dhe si rrjedhim këto 3 mungesa (në datat 1 Prill, 2 dhe 23 Prill 2021) janë hequr në listëpagesën e mëvonshme. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në listpagesën e muajit Maj 2021, ku nëpunësi \*\*\*\*\* , ka të paguara 8 ditë punë, 10 ditë raport dhe 4 ditë ndalesë nga paga (3 ditë nga muaji Prill 2021 dhe 1 ditë në Maj 2021).

Konstatohet se nuk janë ndaluar ditët, e periudhës nga 5-18 Maj 2021, që nëpunësi në fjalë i ka justifikuar mungesat me raport mjekësor.

Nga analiza e veprimeve të mësipërme, rezulton se janë kryer ndalesa nga paga vetëm në ato raste, në të cilat nëpunësi \*\*\*\*\* ka munguar në punë, por nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor justifikues. Veprimet e mësipërme administrative, janë të bazuara në pikën 2, të nenit 130, të ligjit nr. 7961 dt. 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimin Nr. 568, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Vlerësohet i pranueshëm qëndrimi i punëdhënësit në këtë rast, që mungesat e pajustificuara të nëpunësit në fjalë, nuk i ka konsideruar si raste të thyerjes së disiplinës, por është mjaftuar me marrjen e masës administrative të ndalesës nga paga.

Përderisa këto mungesa të pajustificuara janë konsideruar se nuk kanë përmbushur kushtin e germës “ç” të pikës 2 dhe atë të germës “b” të pikës 3, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, (përkatësisht, mungesa të pajustificuara dhe të vijueshme për 7 ditë ose më shumë – shkelje të rënda; mungesa të pajustificuara e të vijueshme për 3 ditë ose më shumë – shkelje të lehta), me të drejtë ëshë mjaftuar me marrjen e masave përkatëse administrative të ndërprerjes së ditës së punës.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 109, germa d), neni 113 dhe nenin 114/1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në mbështetje të Rregullores, “Mbi procedurat e

*mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procedurës administrative, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së disa urdhërave për ndalimin e pagës për disa ditë pune, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\* , me detyrë *“Specialist”*, në Sektorin e Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit Fier, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër dhe meqënëse veprimet administrative të njësisë përgjegjëse gjenden në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, të vendoset arkivimi i çështjes.
- 2 Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Personat e tjerë të interesuar, të marrin dijeni për këtë vendim nëpërmjet faqes zyrtare të KMSHC.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**